

VENDIM
Nr.1202, datë 27.8.2008

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), QË VEPRON NË EMËR TË AGJENCISË ZBATUESE TË SHËRBIMIT GLOBAL MJEDISOR (GEF), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË EKOSISTEMIT TË LIQENIT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare dhe Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron në emër të Agjencisë Zbatuese të Shërbimit Global Mjedisor (GEF), për financimin e projektit të menaxhimit të integruar të ekosistemit të liqenit të Shkodrës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ASISTENCA PËR MJEDISIN GLOBAL MARRËVESHJE GRANTI NGA FONDI I BESIMIT (PROJEKT PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË EKOSISTEMEVE NË LIQENIN SKADAR-SHKODËR) NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM E CILA VEPRON NË EMËR TË AGJENCISË ZBATUESE TË SHËRBIMIT GLOBAL MJEDISOR

MARRËVESHJE GRANTI
NGA FONDI I BESIMIT

Marrëveshja e datës.....2008, e cila hyn në fuqi ndërmjet Shqipërisë (Përfituesi); dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), e cila vepron si Agjencia Zbatuese e Shërbimit Global Mjedisor (“SHGM”).

Përfituesi dhe Banka Botërore nëpërmjet kësaj marrëveshjeje bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushtet standarde, përkufizimet

1.01 Kushtet standarde për grantet e dhëna nga Banka Botërore nga fondet e ndryshme, të datës 20 korrik 2006 (Kushtet standarde) janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Fjalët dhe termat me shkronja kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje kanë po ato kuptime që u janë caktuar atyre sipas kushteve standarde ose sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse konteksti ku ato përdoren nuk e specifikon ndryshe.

Neni 2
Projekti

2.01 Përfituesi deklaron angazhimin e tij për realizimin e objektivave të projektit të përshkruar në Programin 1 të kësaj Marrëveshjeje Projekti. Për këtë qëllim, Përfituesi do të realizojë projektin nëpërmjet MMPAU në përputhje me dispozitat e nenit II të kushteve standarde.

2.02 Përfituesi duhet të sigurojë që projekti të realizohet në përputhje me dispozitat e programit 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe pa kufizime ndaj dispozitave të seksionit 2.01 po të kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të rastit kur Përfituesi dhe Banka Botërore bien dakord ndryshe.

Neni 3

Granti

3.01 Banka Botërore bie dakord t'i japë Përfituesit sipas termave dhe kushteve të vendosura në këtë Marrëveshje një grant në shumën e një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë dollarë amerikanë (\$1,990,000) (Grant) për të ndihmuar financimin e këtij projekti.

3.02 Përfituesi mund të zgjedhë të tërhiqet nga ky grant në përputhje me seksionin IV të programit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Zgjidhje plotësuese

4.01 Rastet shtesë të pezullimit të grantit të përshkruar në seksionin 4.02 (i) të "Kushteve standarde" përbëhen nga sa më poshtë:

a) Përfituesi nuk përmbush asnjë detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas Marrëveshjes bilaterale.

b) Si rezultat i ngjarjeve që ndodhin pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, mund të ndodhë një situatë e jashtëzakonshme, e cila do ta bëjë të pamundur përmbushjen e detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje ose të Marrëveshjes bilaterale nga Përfituesi ose kur Komisioni i liqenit të Shkodrës, për shkak të tyre, e çmon të pamundur përmbushjen e detyrimeve sipas Marrëveshjes bilaterale.

c) Banka Botërore pezullon plotësisht ose pjesërisht të drejtën e Malit të Zi të tërhiqet nga Marrëveshja e Malit të Zi me SHGM, për shkak të pamundësisë së Malit të Zi për të përmbushur çdo detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje.

d) Banka Botërore vendos pas datës të hyrjes në fuqi, të përmendur në seksionin 5.03, të kësaj Marrëveshjeje, që para kësaj date por pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, një ngjarje mund të ndodhë, e cila i jep të drejtë Bankës Botërore të pezullojë të drejtën e Përfituesit që të tërheqë nga llogaria e grantit, në qoftë se kjo Marrëveshje është në veprim në datën kur ka ndodhur kjo ngjarje.

Neni 5

Efektiviteti, përfundimi

5.01 Kjo Marrëveshje nuk do të bëhet e zbatueshme deri sa Bankës t'i përcillen prova të pranueshme se janë plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) Përmbushja dhe realizimi i Marrëveshjes së grantit nga SHGM në emër të Përfituesit është autorizuar dhe miratuar sipas rregullave në përputhje me çdo veprim të nevojshëm të qeverisë.

b) Manuali i zbatimit të projektit, i pranueshëm për Bankën, miratohet si i tillë nga

Përfituesi.

c) Marrëveshja e SHGM me Malin e Zi është realizuar dhe përmbushur dhe të gjitha kushtet që i paraprijnë hyrjes në fuqi të saj janë përmbushur, me përjashtim të hyrjes në fuqi të marrëveshjes SHGM ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Botërore.

5.02 Si pjesë e dokumentacionit që përcillet te pala tjetër sipas seksionit 5.01 (a) Bankës Botërore duhet t'i përcillet një opinion ose opinione të pranueshme nga konsulenti i pranuar nga Banka, ose, me kërkesë të Bankës Botërore, një certifikatë e lëshuar nga një zyrtar kompetent i vendit anëtar i pranueshëm nga Banka Botërore, që tregon në emër të Përfituesit se kjo Marrëveshje është pranuar dhe nënshkruar sipas rregullave dhe se është përmbushur dhe realizuar në emër të Përfituesit dhe se është e detyrueshme në përputhje me kushtet e saj.

5.03 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën që Banka Botërore i dërgon Përfituesit një njoftim të pranimit të provës së kërkuar sipas seksionit 5.01 (Data e hyrjes në fuqi), me përjashtim të rasteve kur Përfituesi dhe Banka Botërore bien dakord për veprime të tjera. Në qoftë se para datës së hyrjes në fuqi, ndodh ndonjë situatë që do t'i jepte të drejtë Bankës Botërore të pezullonte të drejtën e Përfituesit të tërheqë nga llogaria e grantit, në rast se kjo Marrëveshje do të kishte hyrë në fuqi, Banka Botërore mund të shtyjë dërgimin e njoftimit të përmendur në këtë seksion derisa një ngjarje (ose ngjarje) e tillë të ketë pushuar së ekzistuari.

5.04 Kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e Palëve në të do të përfundojnë në qoftë se ajo nuk hyn në fuqi pas 90 ditësh nga data e nënshkrimit, nëse Banka Botërore, pas shqyrtimit të arsyeve të vonësës së saj, nuk vendos një datë të dytë për qëllim të këtij seksioni. Banka Botërore duhet të njoftojë menjëherë Përfituesin për këtë datë të dytë.

Neni 6

Përfaqësuesi i Përfituesit, adresat

6.01 Përfaqësuesi i Përfituesit i përmendur në seksionin 7.02 të kushteve standarde është Ministri i Financave.

6.02 Adresa e përfituesit, e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde, është:

Ministria e Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Tiranë, Shqipëri

Faks:

355 42 28494

6.03 Adresa e Bankës Botërore, e përmendur në Seksionin 7.01 të kushteve standarde, është:

Banka Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Kabëll:

Teleks:

Faks:

INTBAFRAD

248423 (MCI) ose

1-202-477-6391

Washington, D.C.

64145 (MCI)

Nënshkruar në _____, _____, sipas datës dhe vitit të shkruar fillimisht më lart.

PROGRAMI I

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i projektit është të ndihmojë në krijimin dhe forcimin e mekanizmave

institucionale për bashkëpunim ndërkufitar përmes përpjekjeve të përbashkëta për të përmirësuar menaxhimin e qëndrueshëm të liqenit Skadar-Shkodër.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa A: Krijimi i kapaciteteve për një kuptim më të plotë dhe një menaxhim të përbashkët të liqenit Skadar-Shkodër

Krijimi dhe forcimi i strukturave institucionale për menaxhimin bashkëveprues të liqenit Skadar-Shkodër, duke përfshirë funksionimin e Komisionit të liqenit të Shkodrës (KLSH), Grupeve të punës së KLSH dhe sekretariatit të KLSH, si dhe mbështetja për grupet e punës së KLSH-së në zbatimin e programeve të tyre të punës.

Pjesa B: Nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të liqenit Skadar-Shkodër

Nxitja dhe mbështetja e përjasjeve të qëndrueshme mjedisore dhe sociale në menaxhimin e turizmit dhe peshkimit, duke përfshirë përmirësimin e natyrës dhe shërbimeve kulturore, dhe zhvillimi i një programi për vlerësimin e specieve në mbarë liqenin dhe për menaxhimin e peshkimit.

Pjesa C: Përshpejtimi i investimeve për reduktimin e ndotjeve

1. Zhvillimi i një sistemi të vogël të trajtimit të ujërave të ndotura në Vranjina.
2. Mbështetje në përgatitjen e një plani rregullues mjedisor për vendin e grumbullimit dhe hedhjeve të mbetjeve të ngurta në Kombinat Aluminjuma Podgorica.
3. Restaurimi i ekosistemit të bregut të liqenit.

PROGRAMI 2 REALIZIMI I PROJEKTIT

Seksioni I. Marrëveshjet institucionale dhe të tjera

A. Marrëveshjet institucionale

Përfituesi do të realizojë projektin në përputhje me marrëveshjet e mëposhtme institucionale:

1. Komisioni i liqenit të Shkodrës (KLSH) nëpërmjet konsulencës teknike të grupeve të punës të KLSH do të jetë përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve midis Përfituesit dhe Qeverisë së Malit të Zi sipas projektit. Ai do të koordinojë edhe konsulencën teknike në mënyrë që të jetë në përputhje me Marrëveshjet bilaterale.

2. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, nëpërmjet njësisë së menaxhimit të projektit pranë MMPAU do të jetë përgjegjëse për zbatimin, raportimin e ecurisë së projektit, për prokurimet dhe menaxhimin financiar dhe për aktivitetet menaxhuese mjedisore të pjesëve A, B, dhe C3 të projektit, me asistencën teknike të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me bashkinë e Shkodrës dhe me njësinë e menaxhimit të rezervave natyrore të liqenit të Shkodrës për pjesën B të projektit.

B. Kontratat e zbatimit

1. Përfituesi do të mbështesë financiarisht Komisionin e liqenit të Shkodrës (KLSH), grupet e punës së KLSH-së, sekretariatit të KLSH-së dhe njësinë e menaxhimit të projektit pranë MMPAU gjatë gjithë kohës së zbatimit të projektit sipas termave të referencës dhe me burime të pranueshme nga ana e Bankës Botërore, dhe me staf të aftë e të mjaftueshëm në numër.

2. Përfituesi, përmes KLSH-së dhe grupeve të punës së KLSH-së dhe sekretariatit të KLSH-së dhe me njësinë e menaxhimit të projektit pranë MMPAU do të:

i) realizojë siç duhet të gjitha detyrimet sipas manualit të zbatimit të projektit, kuadrin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, planet e menaxhimit të mjedisit dhe kuadrin e procesit në kohën e duhur dhe në përputhje me kushtet përkatëse dhe do të aplikojë e zbatojë, sipas rastit, veprimet, kriteret, politikat, procedurat dhe masat e vendosura; dhe

ii) nuk do të amendojë apo heqë dorë, ose të lejojë të amendojnë apo të heqin dorë nga manuali i zbatimit të projektit, kuadri i vlerësimit të ndikimit në mjedis, plani i menaxhimit të mjedisit ose kuadri i procesit apo ndonjë dispozitë tjetër, me përjashtim të rasteve kur këto

miratohen nga Banka Botërore.

3. Jo më vonë se 1 janari 2009, Përfituesi duhet të krijojë dhe të mbështesë me staf njësinë e menaxhimit pranë MMPAU sipas kushteve dhe termave të referencës të pranueshme nga Banka Botërore.

4. Para fillimit të punimeve sipas pjesëve B dhe C3 të projektit, Përfituesi do të përgatisë një plan të menaxhimit të mjedisit në mënyrë të tillë që ky të jetë i pranueshëm nga Banka Botërore.

Seksioni II. Monitorimi i projektit, raportimi dhe vlerësimi

A. Raportet e projektit, raporti përfundimtar

1. Përfituesi do të monitorojë dhe vlerësojë progresin e projektit dhe do të përgatisë raportet e projektit në përputhje me seksionin 2.06 të kushteve standarde dhe në bazë të treguesve të miratuar nga Banka Botërore. Çdo raport i projektit duhet të trajtojë periudhën e një (1) semestri kalendarik i cili duhet t'i dorëzohet Bankës jo më vonë se një (1) muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga secili raport.

2. Përfituesi do të përgatisë raportin përfundimtar në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të kushteve standarde. Raporti përfundimtar do t'i dorëzohet Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas datës së mbylljes së projektit.

B. Menaxhimi financiar, raportet financiare, auditimet

1. Përfituesi do të sigurojë që sistemi i menaxhimit financiar të realizohet në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 të kushteve standarde.

2. Përfituesi do të sigurojë që raportet financiare të përkohshme jashtë fokusit të auditimit të përgatiten dhe t'i dërgohen Bankës Botërore jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas mbylljes së secilit tremujor kalendarik në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Banka Botërore.

3. Përfituesi duhet të realizojë auditimin e deklaratave financiare për projektin në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 (b) të kushteve standarde. Çdo auditim i tillë i deklaratave financiare do të mbulojë periudhën e një viti fiskal të Përfituesit. Deklaratat financiare të auditimit për secilën periudhë do t'i dorëzohen Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i një periudhe të tillë kohore.

Seksioni III. Prokurimet

A. Të përgjithshme

1. Prokurimi dhe udhëzimet e konsulentit. Të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet që kërkohen për projektin dhe financohen nga shumat e grantit do të prokurohen në përputhje me kriteret e parashtruara këtu ose të përmendura në:

a) Seksionin I i "Udhëzimeve: Prokurimet sipas huasë IBRD dhe kredive IDA" botuar nga Banka Botërore në muajin maj 2004 (Udhëzimet e prokurimeve) në rastin e mallrave dhe punimeve dhe seksionin I dhe IV të "Udhëzimeve: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore" botuar nga Banka Botërore në maj 2004 (Udhëzime për konsulentët) në rast se kërkohen shërbimet e konsulentëve; dhe

b) Dispozitat e seksionit III, të cilat duhet të merren parasysh në hartimin e planit të prokurimeve që duhet të përditësohet vazhdimisht nga Përfituesi i projektit në përputhje me paragrafin 1.16 të udhëzimeve të prokurimeve dhe paragrafit 1.24 të udhëzimeve të konsulentit (Plani i prokurimeve).

2. Përkufizimet. Termat me shkronja kapitale të përdorura më poshtë për të përshkruar metodat e veçanta të prokurimeve ose metodat e shqyrtimit nga Banka Botërore të kontratave të ndryshme, u referohen metodave të ngjashme si ato që përshkruhen në udhëzimet e prokurimeve ose në udhëzimet e konsulentit, sipas rastit.

B. Metodatat e veçanta të prokurimit të mallrave dhe punimeve

1. Tenderi konkurrues ndërkombëtar. Vetëm në rastet kur specifikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat dhe punimet do të prokurohen sipas kontratave të lidhura në bazë të tenderit konkurrues ndërkombëtar.

2. Metodat e tjera të prokurimit të mallrave dhe punimeve. Metodat e mëposhtme, që përjashtojnë tenderin konkurrues ndërkombëtar, mund të përdoren në prokurimin e mallrave dhe punimeve për kontrata të specifikuara në planin e prokurimeve.

Metodat e prokurimeve
a) Tenderi konkurrues kombëtar – me modifikimet e parashtruara në paragrafin 3 më poshtë
b) Blerjet
c) Kontraktimi i drejtpërdrejtë

3. Modifikimet e procedurave të tenderit konkurrues kombëtar të Përfituesit

Procedurat e tenderit konkurrues kombëtar do të bazohen në procedurat e tenderit të hapur, bazuar në Ligjin Shqiptar të Prokurimeve Publike dhe në dispozitat e mëposhtme:

i) Procedurat e “Tenderit të hapur” siç përcaktohen në ligjin shqiptar të prokurimeve do të aplikohen për të gjitha kontratat;

ii) Ofertuesit e huaj nuk do të përjashtohen nga tenderimi dhe asnjë preferencë e çfarëdo lloji nuk do t’u jepet ofertuesve vendas në procesin e tenderimit. Ndërmarrjet shtetërore në Shqipëri do të lejohen të konkurrojnë në qoftë se janë financiarisht dhe ligjërisht autonome dhe nëse operojnë sipas ligjeve tregtare të Përfituesit;

iii) Entet prokuruese do të përdorin dokumentet tip të ofertës të miratuara nga Banka Botërore;

iv) Në rast se çmimet më të larta të ofertës janë të krahasueshme me çmimet e përafërta zyrtare, atëherë këto oferta nuk do të përjashtohen pa marrë fillimisht miratimin nga Banka Botërore;

v) Do të përdoret procedura e një zarfi të vetëm për dorëzimin e ofertave;

vi) Paskualifikimi do të realizohet vetëm për ofertuesin e vlerësuar me çmimin më të ulët dhe asnjë ofertë nuk do të përjashtohet në kohën e hapjes së ofertave për arsye kualifikimi;

vii) Ofertuesit të cilët kontraktohen si kompani me kapitale të përbashkëta do të jenë përgjegjëse bashkërisht dhe veçmas;

viii) Kontratat do t’u jepen ofertuesve të vlerësuar me çmimin më të ulët që janë të përgjegjshëm dhe që janë të vendosur të kualifikohen për realizimin e kontratës në përputhje me kriteret e vlerësimit të para-përcaktuara dhe të bëra publike më parë;

ix) Pas dorëzimit të ofertës nuk do të lejohen negociatat me ofertuesin e vlerësuar me çmimin më të ulët apo me ofertues të tjerë;

x) Kontratat afatgjata (më shumë se 18 muaj) duhet të përmbajnë dispozitat e duhura të përshtatjes së çmimit.

C. Metodat e veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve

1. Përzgjedhja e bazuar në cilësi dhe kosto. Vetëm në rastet kur përcaktohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e ‘konsulentëve’ do të prokurohen sipas kontratave të lidhura në bazë të përzgjedhjes me bazë cilësinë dhe koston.

2. Metodat e tjera të prokurimeve të shërbimeve të konsulentëve. Metodat e mëposhtme, ndryshe nga përzgjedhja në bazë të cilësisë dhe koston, mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për detyra të cilat specifikohen në planin e prokurimeve: a) përzgjedhja me koston më të ulët; b) përzgjedhja me një buxhet fiks; c) përzgjedhja e bazuar në kualifikimet e konsulentëve; d) përzgjedhja nga një burim i vetëm; e) përzgjedhja e konsulentëve

individualë.

D. Rishikimi i vendimeve të prokurimeve nga banka botërore

1. Plani i prokurimeve duhet të përmbajë ato kontrata të cilat do t'i nënshtrohen rishikimit paraprak nga Banka Botërore. Të gjitha kontratat do t'i nënshtrohen rishikimit të mëpasshëm nga ana e Bankës Botërore.

Seksioni IV. Tërheqja e shumave të grantit

A. Të përgjithshme

1. Përfituesi mund të tërheqë shumat nga Granti në përputhje me dispozitat e: a) nenit III të kushteve standarde; b) këtij seksioni, dhe c) udhëzimeve plotësuese që Banka Botërore mund të specifikojë me anë të një njoftimi për Përfituesin (Përfshirë “Udhëzimet e disbursimit të Bankës Botërore për projektet”, të muajit maj 2006, siç rishikohet dhe bëhet e aplikueshme herë pas here për këtë Marrëveshje sipas këtyre udhëzimeve), për të financuar shpenzimet e pranueshme ashtu siç paraqiten në tabelë në paragrafin 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e shpenzimeve të pranueshme që mund të financohen nga shumat e grantit (Kategori), alokimet e secilës shumë të grantit për secilën kategori, si dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohet për shpenzimet e pranueshme në secilën kategori.

Kategoria	Shuma e grantit e alokuar (e shprehur në dollarë amerikanë USD)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen
(1) Mallrat, shërbimet e konsulentëve dhe kostot operative, si dhe trajnimi për pjesët A, B, dhe C3 të projektit dhe punimet për pjesën A të projektit	1,560,000	100%
(2) Punimet për pjesët B dhe C3 të projektit	430,000	100%
Shuma totale	1,990,000	

B. Kushtet e tërheqjes, periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht dispozitave të pjesës A të këtij seksioni, asnjë tërheqje shume nuk do të kryhet:

a) për pagesat e bëra para datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur tërheqjet deri në një shumë totale që nuk tejkalojnë vlerën e barabartë me \$ 100 000, mund të bëhen për pagesat e bëra para kësaj date por jo në dhe më vonë se data 1 nëntor 2007, për shpenzime të pranueshme sipas kategorisë 1; ose

b) sipas kategorisë 2 nëse planet e menaxhimit të mjedisit nuk janë përgatitur në përputhje me paragrafin 4 të seksionit IB të programit 2 të kësaj Marrëveshjeje; ose

2. Data e përfundimit e përmendur në seksionin 3.06 (c) të kushteve standarde është data 30 shtator 2012.

SHTOJCA PËRKUFIZIMET

1. “Marrëveshje bilaterale” do të thotë “Marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të Republikës së Malit të Zi dhe Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të

Ujërave të Shqipërisë për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të liqenit Skadar/Shkodër” të datës 28 shkurt 2008.

2. “Kategori” do të thotë një kategori e vendosur në tabelë në seksionin IV të programit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

3. “Udhëzime për konsulentin” do të thotë “Udhëzime: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore” të botuara në muajin maj 2004 nga Banka Botërore.

4. “PMM” do të thotë plan i menaxhimit të mjedisit të përgatitur nga Përfituesi sipas paragrafit 4 të seksionit IB të programit 2 të kësaj Marrëveshjeje, e pranueshme nga Banka Botërore dhe që përbehet nga një sërë masash zbutëse, monitoruese dhe institucionale që duhet të merren për eliminimin e ndikimeve të pafavorshme mjedisore dhe sociale, për mënjanimin ose reduktimin e tyre në nivele të pranueshme, si dhe nga veprime të tjera të nevojshme për zbatimin e këtyre masave, për projektin; ndaj “PMM” i referohet një plani të tillë të menaxhimit mjedisor”.

5. “Kuari VNM” do të thotë kuadri i vlerësimit të ndikimit në mjedis, përgatitur nga Përfituesi dhe i pranueshëm për Bankën Botërore, i muajit maj 2007, dhe i përfshirë në seksionin e mjedisit në manualin e implementimit të projektit, ku përshkruhen rregullat, udhëzimet dhe procedurat në vlerësimin e impakteve mjedisore dhe përcaktohen masat për të reduktuar, zbutur dhe mënjauar impaktet e pafavorshme mjedisore të investimeve sipas Projektit, përfshirë impaktet ndërkuftare dhe detyrimet ndërkombëtare si dhe forcimi i impakteve pozitive të investimeve të tilla, të cilat mund të amendohen herë pas here me miratimin e mëparshëm të Bankës Botërore.

6. “KAP” do të thotë kombinati i aluminit në Podgoricë, një kompani private me kapitale të përbashkëta e angazhuar në prodhimin e produkteve të aluminit dhe e regjistruar nga Gjykata Tregtare e Malit të Zi më 30 nëntor 2005, ose pasuesi apo pasuesit e saj.

7. “MMPAU” do të thotë Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave e Përfituesit ose pasuesi apo pasuesit e saj.

8. “NJMP pranë MMPAU” do të thotë njësi e menaxhimit të projektit brenda MMPAU, përgjegjëse për zbatimin e projektit sipas Programit 2 të kësaj Marrëveshjeje që përfshin stafin e mëposhtëm, kualifikimet dhe termat e referencës të të cilit do të jenë të pranueshme nga Banka Botërore: i) drejtor i projektit; ii) koordinator i projektit; iii) specialist i prokurimeve; dhe iv) specialist i menaxhimit financiar.

9. “Marrëveshja SHGM –Mali i Zi” do të thotë Marrëveshja e Grantit Mjedisor të Fondit të Besimit ndërmjet Malit të Zi dhe Bankës Botërore që do të mbajë të njëjtën datë me datën e kësaj Marrëveshjeje.

10. “MTMM” do të thotë Ministria e Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Malit të Zi dhe çdo institucion me të njëjtin emërtim pas kësaj.

11. “MTKRS” do të thotë Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Përfituesit dhe përfshin çdo institucion pasues me këtë emër.

12. “Bashkia e Shkodrës” do të thotë Bashkia Shkodër e Përfituesit, e krijuar sipas ligjit “Mbi ndarjen administrative dhe territoriale të njësive të qeverisë vendore në Shqipëri”, e datës 31 korrik 2000 e botuar në Fletoren Zyrtare nr. 26/2000.

13. “Kostot operative” do të thotë shpenzimet e arsyeshme dhe të nevojshme në rritje që lidhen me funksionimin e NJMP pranë MMPAU, me Këshillin e liqenit të Shkodrës (KLSH), me grupet e punës së KLSH dhe me sekretariatit e KLSH, përkatësisht përfshirë në llogari të zbatimit të projektit edhe menaxhimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin të miratuara nga Banka Botërore në bazë të zërave të buxhetit të miratuara po nga Banka Botërore, të cilat nuk duhet të përdoren jashtë projektit dhe që duhet të përfshijnë, ndër të tjera, kostot e: i) mirëmbajtjes dhe funksionimit të pajisjeve të prokuruar dhe të përdorura për menaxhimin e projektit; ii) kostot e udhëtimit dhe dietat; iii) pajisje zyresh të konsumit të përditshëm; iv) komunikimin, printimet dhe botimet; v) kostot e përkthimit dhe interpretimit; dhe vi) tarifatat bankare; si dhe kosto të tjera të shumta siç miratohen herë pas here nga Banka Botërore.

14. “Kuari i procesit” do të thotë kuari i procesit të kufizimit të aksesit ndaj burimeve për projektin e menaxhimit të ekosistemeve të integruara, i nënshkruar nga Përfituesi më 15 mars 2007 dhe i miratuar nga Banka, për të udhëzuar zbutjen e impakteve potencialisht negative në jetesën e popullatës pranë liqenit të Skadar-Shkodrës. Kjo mund të modifikohet herë pas here me Marrëveshje ndërmjet Përfituesit dhe Bankës Botërore.

15. “Udhëzimet e prokurimeve” do të thotë “Udhëzimet: Prokurimet sipas huasë IBRD dhe kredisë IDA” të botuara nga Banka në maj 2004.

16. “Plani i prokurimeve” do të thotë plani i prokurimeve të Përfituesit për projektin e datës 23 prill 2008 dhe të përmendura në paragrafin 1.16 të udhëzimeve të prokurimeve dhe paragrafin 1.24 të udhëzimeve të konsulentit, që do të përditësohen herë pas here në përputhje me dispozitat në paragrafët më lart.

17. “Manuali i zbatimit të projektit” do të thotë manuali i përgatitur nga Përfituesi dhe i miratuar nga Banka Botërore, referuar në nënparagrafin (b) të seksionit 5.01 të kësaj Marrëveshjeje, që paraqet përgjegjësitë operative dhe administrative, procedurat dhe rregullat për zbatimin e projektit, përfshirë dhe kuadrin e VNM, rregullat e menaxhimit financiar për projektin, që mund të amendohen dhe plotësohen herë pas here paraprakisht me miratimin me shkrim të Bankës Botërore.

18. “Njësia e menaxhimit BNLSH” do të thotë njësia e menaxhimit të burimeve natyrore të liqenit të Shkodrës e cila duhet të krijohet dhe të mblidhet sipas paragrafit 3 të Seksionit Ib të programit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

19. “KLSH” do të thotë komisioni i liqenit të Shkodrës, një organ bilateral i krijuar në përputhje me nenin 5 të Marrëveshjeve Bilaterale si forum për koordinimin e problemeve të menaxhimit të liqenit i mbështetur nga grupet e punës dhe sekretariati i KLSH.

20. “Sekretariati i KLSH” do të thotë sekretariati i vendosur në Shkodër, në Shqipëri, që do të krijohet nën drejtimin e KLSH për të lehtësuar komunikimin me publikun dhe për t’i raportuar drejtorit të projektit pranë njësisë së menaxhimit të projektit pranë MTMM dhe drejtorit të projektit të NJMP pranë MMPAU përfshirë stafin e mëposhtëm, kualifikimet dhe termat e referencës të cilëve duhet të miratohen nga Banka Botërore : i) një krye-sekretare; dhe ii) një asistent .

21. “Grupet e punës së KLSH” do të thotë 4 grupet e punës të specialistëve teknikë dhe grupet lokale të interesit që do të thirren nga KLSH për arritjen e objektivave të projektit për t’u këshilluar për probleme që lidhen me liqenin si me poshtë: 1) Aspekte ligjore dhe të planifikimit; 2) Monitorimin dhe kërkimin; 3) Komunikimin/shpërndarjen dhe turizmin e qëndrueshëm; dhe 4) Menaxhimi i ujërave.

22. “Trajnimi” do të thotë aktivitete (veç atyre “këshillimore”) që do të realizohen në këtë projekt, siç miratohen nga Banka Botërore në bazë të trajnimit vjetor dhe mbi bazë të planeve të tureve studimore, të pranueshme nga Banka Botërore, përfshirë udhëtimin e nevojshëm brenda dhe jashtë vendit dhe shpenzimet e vizave të pjesëmarrësve që marrin pjesë në kurset e trajnimit si dhe akomodimin, dietat ushqimore, dietat lokale dhe ndërkombëtare në përputhje me udhëzimet e Përfituesit, regjistrimin, pagesat e trajnerëve dhe ofertuesve të shërbimeve, shpenzimet e vogla organizative (përfshirë kostot e artikujve të shkrimit, printimit si dhe materialet e trajnimit), kostot e përkthimit dhe interpretimit, kostot e marrjes me qera të ambienteve dhe shpenzimeve të tjera që lidhen direkt me seminarët e trajnimit dhe aktivitetet e një vizite studimore, siç miratohen në bashkëpunim me Përfituesin.

Shtojca 4 – Letër plotësuese

SHQIPËRI

,2008

Banka Ndërkombëtare
për Rindërtim dhe Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America

Re: Granti i Fondit të besimit nr:Al
(Projekti i menaxhimit të ekositemit të liqenit Skadar-Shkodër)
Treguesit e monitorimit të performacës

Të nderuar zonja dhe zotërinj:

Kjo letër i referohet paragrafit A. 1, seksionit II të programit 2 të Marrëveshjes së Grantit të Fondit të Besimit të GEF ndërmjet Shqipërisë (Përfituesi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), që vepron si agjenci zbatuese e Global Environment Facility (GEF), për projektin e referuar më sipër. Me anë të kësaj letre, Përfituesi i konfirmon Bankës Botërore që treguesit e dhënë në shtojcën e kësaj letre do të shërbejnë si bazë që Përfituesi të monitorojë dhe vlerësojë progresin e projektit dhe arritjet e objektivave të tij.

Me respekt dhe konsideratë,
Shqipëria

Nga _____
Përfaqësuesi i autorizuar

Shtojcë

Projekti i Menaxhimit të Ekosistemit të Integruar të Liqenit Skadar-Shkodër

Treguesit e Monitorimit të Performancës

Kuadri i Rezultateve

PDO dhe GO	Treguesit e Rezultateve të Projektit	Përdorimi i Informacionit të Rezultateve të Projektit
Ruajtja dhe përmirësimi i vlerës afat-gjatë ekonomike dhe shërbimeve mjedisore të Liqenit Skadar-Shkodër dhe burimeve të tij natyrore (GO); dhe Ndihma për krijimin dhe forcimin e mekanizmave institucionalë për bashkëpunimin ndërkufitar përmes përpjekjeve të përbashkëta për të përmirësuar menaxhimin e qëndrueshëm të Liqenit Skadar-Shkodër (PDO).	Kërcënimet e menjëhershme dhe afat-gjata kundër cilësisë së ujit dhe sistemit ekologjik pakësohen në të dy anët e kufirit, nëpërmjet investimeve të drejtpërdrejta, shkëmbimit të informacionit, planifikimit dhe marrëveshjeve dypalëshe. Statusi i treguesve kryesorë ndërkufitarë i cilësisë së ujit dhe atyre ekologjikë ruhet apo përmirësohet.	Monitorimi specifik do të tregojë nëse investimet në terren po japin ndikimet e dëshiruara mbi cilësinë e ujit dhe shëndetin e ekosistemit. Nëse jo, Grupeve dypalëshe të Punës do t'u kërkohet të identifikojnë prioritetet e tjera në investime. Niveli dhe cilësia e pjesëmarrjes, dhe ndjekja e rezultateve në proceset ndërkufitare do të tregojnë efektivitetin e këtyre mekanizmave institucionalë për të lehtësuar bashkëpunimin në nivel teknik dhe politik. Treguesit e rënies së parametrave kryesorë të cilësisë së ujit dhe atyre ekologjikë, si dhe aksesit i publikut në këtë informacion nëpërmjet bazës dypalëshe të të dhënave, do të vërë në lëvizje përpjekjet për të identifikuar shkaqet kryesore dhe për të ndërtuar angazhimin për zgjidhjen e tyre.
Rezultatet e Ndërmjetme	Treguesit e Rezultateve të Ndërmjetme	Përdorimi i Monitorimit të Rezultateve të Ndërmjetme

Komisioni i Liqenit Skadar-Shkodër (SLC) dhe Grupet e Punës janë operacionale, dhe janë identifikuar në SAP aktivitetet prioritare të përbashkëta të qëndrueshme dhe zbatuese).	Kostot operative të mirëmbajtjes dhe pjesëmarrjes në SLC, baza e të dhënave për gjithë liqenin dhe Grupet e Punës janë të përfshira në buxhetet e Qeverive një vit para mbylljes së projektit. (P) Modeli parashikues hidrologjik i Liqenit Skadar-Shkodër është përfunduar dhe përdoret për të analizuar ndikimet e mundshme të politikave dhe investimeve të propozuara. (P) Zonimi në gjithë liqenin dhe plani i menaxhimit miratohen nga të dyja qeveritë dhe përfshihen në përditësimet e planit hapësinor. (P)	Mbështetja e qeverive për këto struktura institucionale një vit para mbylljes së projektit do të pasqyrojë dobinë e tyre dhe angazhimin e Qeverive ndaj bashkëpunimit ndërkufitar për menaxhimin e liqenit sipas Marrëveshjes Dypalëshe. Nga ana tjetër, nëse njëra apo të dyja qeveritë nuk përballojnë këto shpenzime, do të tregonte një nevojë për ndërgjegjësim të mëtejshëm dhe shqyrtim të mundësive të tjera për institucionalizimin e bashkëpunimit. Nëse modeli hidrologjik i liqenit përdoret në mënyrë aktive nga grupet e interesit dhe vendim-marrësit për të analizuar ndikimet e mundshme të projekteve të propozuara të zhvillimit dhe investimet në basenin e liqenit, kjo do të përmirësonte nivelin e debatit të mirëinformuar rreth shkëmbimeve në nivele kombëtare dhe ndërkufitare/rajonale. Nëse modeli nuk përdoret, do të organizohen konsultime me grupet e interesit për të zbuluar arsyet përkatëse (p.sh. publicitet i pamjaftueshëm; projekti pamjaftueshmërisht informues apo operativ dhe jo lehtësisht i përdorshëm) Plani i menaxhimit të gjithë liqenit do të japë një kontribut thelbësor për përmirësimin e planeve lokale dhe kombëtare hapësinore, të cilat japin bazën ligjore për kontrollin dhe rregullimin e zhvillimit, përdorimin e burimeve natyrore dhe burimet e ndotjes që prekin liqenin.
--	---	---

Kapaciteti rregullator, infrastruktura dhe mekanizmat dhe stimujt e nivelit komunitar janë krijuar për të mbështetur shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit	Rinovimet dhe ndërtimet e synuara të infrastrukturës së turizmit të përfunduara dhe duke tërhequr vizitorë (qendra vizitorësh, vende kulturore, shtigjet, etj.). (P) Reduktimi i numrit të peshkatarëve që përdorin metoda të paligjshme peshkimi. (S) Studimet/qëndrimet social-ekonomike tregojnë një rritje të kuptimit dhe angazhimit në turizmin e qëndrueshëm dhe menaxhimin e burimeve natyrore. (P)	Të dhënat rreth përdorimit nga turistët të mjediseve në të dy anët e liqenit do të përbënin një bazë për planifikimin e zhvillimit të mëtejshëm të qëndrueshëm të turizmit.
Identifikohen zgjidhjet për uljen e ndotësve toksikë dhe jo-toksikë që futen në Liqenin Lake Skadar-Shkodër dhe merren veprime për uljen e ndotjes.	Marrëveshje e Qeverisë së Malit të Zi/Pronarët e KAP (Rusal) mbi zgjidhjen e parapëlqyer dhe plan veprimi i përbashkët për grumbullimin e mbetjeve të rrezikshme në zonën e KAP-it. (P) Krijohet sistemi i mbledhjes dhe trajtimit të ujërave të zeza në fshatin Vranjina. (S) Zona e bimësisë mbrojtëse të ujit do të rivendoset në zonat pilot për të reduktuar sedimentet dhe rrjedhjen në liqen. (S)	Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Malit të Zi dhe pronarëve të KAP-it mbi zgjidhjen më të mirë (fizibiliteti teknik, kostot, dhe pranimi nga komuniteti) dhe një plan i përbashkët veprimi dhe financiar, janë parakushtet për të vazhduar me investimet e mëdha për të pakësuar këtë kërcënim urgjent dhe të konsiderueshëm për liqenin dhe përdoruesit e tij. Menaxhimi pilot i ujërave të zeza dhe investimet e rehabilitimit ekologjik do të përdoren si modele për t'u përsëritur përgjatë Liqenit. Rezultatet do të shpërndahen dhe nëpërmjet rrjetit IW-Learn për përsëritjen dhe përshtatjen në vende të tjera. Aktivitetet e monitorimit të mbështetura nga projekti do të hartohen për të përcaktuar nëse ndërhyrjet e projektit janë efektive në përmirësimin e cilësisë së ujit që futet në liqen. Nëse problemi vazhdon pavarësisht investimeve, kjo do të tregonte nevojën për të bërë kërkime të mëtejshme për identifikimin e burimeve kryesore të ndotjes.

Masat për monitorimin e rezultateve

Treguesitë e Rezultateve të Projektit	Niveli i krahësues	Mbledhja e të Dhenave dhe Raportimi				Shprehësit dhe Raportet	Instrumentet e Mbledhjes së të Dhenave	Përgjegësia për Mbledhjen e të Dhenave
		YR1	YR2	YR3	YR4			
Janë reduktuar kërcënimet e tanishme dhe më afatgjata për cilësinë e ujit të liqenit dhe sistemin ekologjik.	Kërcënimet e tanishme: mbetje të rrezikshme të ruajtura jo si duhet në vendin e depozitimit që prekin ujërat sipërfaqësorë; pikat e rrethit të ndotjes nga ujërat e zeza të patrajtuara dhe erozioni i dheut.	Shih Treguesit e Rezultateve të Ndërmjetme për Komponentët 1, 2 dhe 3						
(S)	Kërcënimet afatgjatë: mungesa e mekanizmave institucionale (matrëveshjet, planet, rregulloret, stimujt), të dhënat dhe instrumentet analitike për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të liqenit dhe burimeve		Treguesit bazë të cilësisë së ujit në nivelin krahësues			Vjetore apo dy-vjetore	Pajisjet e monitorimit dhe analizës	METP/MEFWA Institucionet e përcaktuara

të tji.	Treguesit bazë të cilësisë së ujit (BOD, Amoniak, Nitritet, Nitratet, CN, Zn, Pb, Cr, Hg, PAH, PCB) në vende të shumëllojshme kampionimi, me të gjitha parametrat e cilësisë së ujit me pak se zbulueshmëria dhe brenda Kategorisë I A (shih Shërbimin A);	Treguesit bazë të cilësisë së ujit në nivelin krahasues apo më mirë.	apo më mirë	Treguesit bazë të cilësisë së ujit në nivelin krahasues apo më mirë	Treguesit bazë të cilësisë së ujit në nivelin krahasues apo më mirë	së cilësisë së ujit.	kombëtare shkencore
Statusi i treguesve kyq ndërkufitarë të cilësisë dhe ekologjisë së cilësisë së ujit të Liqenit, të ruajtura ose të përmirësuara (P)	Treguesit bazë të cilësisë së ujit (BOD, Amoniak, Nitritet, Nitratet, CN, Zn, Pb, Cr, Hg, PAH, PCB) në vende të shumëllojshme kampionimi, me të gjitha parametrat e cilësisë së ujit me pak se zbulueshmëria dhe brenda Kategorisë I A (shih Shërbimin A);	Treguesit bazë të cilësisë së ujit në nivelin krahasues apo më mirë.		Treguesit bazë të cilësisë së ujit në nivelin krahasues apo më mirë	Treguesit bazë të cilësisë së ujit në nivelin krahasues apo më mirë		
	Statusi i treguesve të përzgjedhur ndërkufitarë (përqendrimet të algave, PAH/PCB dhe metalet e rënda në mishin e peshkut, etj.)						

Vendimet/veprimet rreth zhvillimit dhe përdorimit të ujit udhëhiqen nga objektivat, marrëveshjet dhe strukturat dypalëshe (P)	MIM 2003 nënshkruar; Projekt-Marrëveshja Dypalëshe nënshkruar përpara negociatave mbi projektin; Asnjë strukturë dypalëshe e ngritur.	Komisioni dhe 4 Grupet e Punës së Liqenit Skadar- Shkodër të ngritura zyrtarisht; Grupet e Punës përfundojnë deklaratat e vizionit dhe projekt planet e punës	Grupet e Punës i dorëzojnë SLC projekt planet dypalëshe që kërkohen në SAP (turizmi, komunikimi, monitorimi)	Miratimi i planeve dypalëshe nga SLC Identifikohen politika specifike dhe masa veprimi për miratim dypalësh; 30% e kostove të Komisionit të Liqenit Skadar- Shkodra mbulohen nga Buxhetet e Qeverive	SAP përlitësuar në bazë të planeve dypalëshe; Marrëveshja Dypalëshe e përlitësuar në bazë të rekomandimeve nga Grupet e Punës/SLC; 50% e kostove të SLC e mbuluar nga buxhetet e qeverive.	Gjashtë- muajore	Raportet e progresit të projektit, Raportet Vjetore publike të SLC;faqja e internetit të SLC;	MTEP/MEPEA; Sekretariati i Përbashkët i SLC;
---	---	---	---	--	--	---------------------	---	--

Treguesit e Ndërmjetëm të Rezultateve

Komponenti 1: Ndërtimi i Kapaciteteve për Rritjen e Mirëkuptimit dhe Menaxhimit të Përbashkët të Liqenit

SLC dhe Sekretariati, baza e të dhënave për gjithë liqenin dhe Grupet e Punës janë ngritur dhe janë operacionale; koston operative dhe të pjesëmarrjes janë përfshirë në buxhetet e Qeverive pas mbylljes së projektit;	Asnjë nga këto struktura nuk është ngritur;	Janë ngritur SLC dhe Grupet e Punës; dhe janë zhvilluar takimet e para;	Janë zhvilluar 2 takime të SLC, shënimet/përfundimet janë bërë publike;	Janë zhvilluar 2 takime të SLC, shënimet/përfundimet janë bërë publike;	Buxhetet e të dy Qeverive mbështesin koston operative të SLC/ Sekretariatit/GP.	Vjetore	Raportet e progresit të projektit, faqja e internetit e SLC;	Sekretariati i Përbashkët i SLC.
		Janë rekrutuar Sekretariati dhe Koordinatorët e Projektit; zyrat janë pajisur dhe funksionojnë;	Është identifikuar dhe duke u zbatuar të paktën një aktivitet dypalësh për secilin Grup Pune;	Është përfunduar një aktivitet dypalësh për secilin Grup Pune;				
		Janë prokuruar pajisjet/AT për zhvillimin e bazës së të dhënave;	Baza e të dhënave është në funksionim; të dhënat historike janë hedhur.	Baza e të dhënave është përditësuar rregullisht me të dhëna nga të dy vendet.	Baza e të dhënave është përditësuar rregullisht me të dhëna nga të dy vendet.		Faqja e internetit e SLC;	

(P)

Modeli parashikues hidrologjik i Liqenit Skadar-Shkoder është përfunduar dhe përdoret për të analizuar ndikimet e mundshme të politikave dhe investimeve të propozuara. (P)	Nuk ekziston model.	Janë përfunduar Termat e Referencës për hartimin e modelit dhe përzgjedhjen e konsulentit.	Projekt-modeli hidrologjik i është dorëzuar SLC, dhe i është shpërndarë grupeve të interesit për analizë dhe komente.	Modeli përfundimtar hidrologjik është përfunduar, në proces është dhe përhapja.	Modeli hidrologjik përdoret për të analizuar ndikimin e të paktën një zhvillimi të lidhur me ujën në basenin e liqenit.	Draftet dhe komentat e raportit	MTEP; Grupi i Punës së Kërimit dhe Monitorimit; Sekretariati i SLC.
Plani i menaxhimit të liqenit është përfunduar dhe janë marrë veprimet për ta bërë planin ligjëruesht operativ. (P)	Nuk ekziston plan i menaxhimit të liqenit.	Grupi Dypalësh i Punës miraton Termat e Referencës për përgatitjen e planit.	Projekt plani i menaxhimit të Liqenit është përfunduar.	Plani i menaxhimit të liqenit është miratuar nga BLCM pas konsultimeve me grupet e interesit; identifikimi i masave që nevojiten për të vënë ligjëruesht në zbatim planin në të dyja vendet.	Janë marrë veprime për të vënë ligjëruesht në zbatim planin e menaxhimit të liqenit.	Raportet e progresit të projektit, faqja e internetit e SLC	MTEP/MEFWA Sekretariati i Përbashkët i SLC dhe Grupi i Punës i Planifikimit.

Komponenti 2: Promovimi i Përdorimit të Qëndrueshëm të Liqenit

Rehabilitime/ndërtime të synuara të infrastrukturës së turizmit	Ekziston infrastruktura minimale turistike.	Projektet e përfunduara për shërbimet e ecjes, ekotekst, vendet kulturore)	Është përfunduar 25% e punës rehabilituese/ndërtuese.	75% e punës është përfunduar.	100% e punës është përfunduar.	Vjetore	Raportet e progresit të projektit.	MTEP/MEFWA Sekretariati i përbashkët i SLC.
Përfunduar. (S)	Rreth 350 peshkatarë të palicencuar (43% e numrit total);		Peshkatarët e palicencuar nuk kalojnë 30% të numrit total.		Peshkatarët e palicencuar nuk kalojnë 20% të numrit total;	Çdo 2 vjet.	Vëzhgim në terren (përsëritja e vëzhgimit bazë të marrë gjatë fazës përgatitore)	MEFWA, Autoriteti i SLMNR
(S)	814 raste të metodave ligjore të vëzhguara gjatë një vëzhgimi një javor.		Jo më shumë se 400 raste të metodave të paligjshme të vëzhguara gjatë një jave.		Jo më shumë se 100 raste të metodave të paligjshme të vëzhguara gjatë një jave.			
Rritje e ndërgjegjësimit lokal dhe angazhimit në turizëm të qëndrueshëm dhe menaxhimin e burimeve natyrore. (P)	TBD: vëzhgimi për tu ndërmarrë gjatë vitit të parë të projektit.	Përfundimi i vëzhgimit, dhënia e treguesve, masat bazë dhe synimet për ndërgjegjësim dhe angazhim.			Treguesit e ndërgjegjësimit dhe angazhimit arrijnë të paktën 70% të niveleve të synuara.	Vëzhgimi i kryer në Vitin 1, dhe përsëritur në Vitin 3 dhe 4.	Vëzhgim social-ekonomik.	MTEP/MEFWA

Komponenti 3: Nxitja e Investimeve për Reduktimin e Ndjeljes

Komponenti 3: Nxijtja e Investimeve për Reduktimin e Ndotjes

Marrëveshje e Qeverisë së Malit të Zi/pronarët e KAP (Rusa) mbi zgjidhjen e parapëlqyer dhe planit të përbashkët të veprimit për izolimin/eliminimin e vendit të depozitimit të mbetjeve të rrezikshme në zonën e KAP. (P)	Ka informacion të vjetër dhe të panjafshëm mbi natyrën dhe sasinë e mbetjeve të trashëguara dhe gjendjes së vendit të depozitimit; nuk ka bazë për analizën e alternativave; nuk ka plan veprimi apo marrëveshje mbi rrugën që duhet ndjekur.	Këshilltari Teknik i Qeverisë për Fabrikën e Aluminit tashmë është operacional;	Përfunduar analiza e alternativave; Ka filluar studimin e fizibilitetit dhe VNM.	Përfunduar studimi i fizibilitetit; Q E MZ dhe Pronarët e KAP bien dakord mbi zgjidhjen e parapëlqyer;	Janë përfunduar projekti paraparak dhe VNM; Marrëveshja përfundimtare mbi planin e veprimit dhe financimin, janë miratuar nga Rusal dhe Qeveria e Malit të Zi.	Rregullisht	Raportet e progresit të projektit.	MTEP; KAP/Rusal
--	---	---	---	---	---	-------------	------------------------------------	-----------------

Sistemi i grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza është ndërtuar në fshatin Vranjina (Mali i Zi) (S)	Ka vetëm instalime hidrosantare, gropa septike përgjithësisht jo-funksionale. Ndojje e dukshme në derdhje.	Vranjina: parametrat bazë të cilësive së ujit janë regjistruar në vendet pilot; ka filluar ndërtimi i sistemit të grumbullimit të ujërave të zeza.	Vranjina: Ka përfunduar sistemin i grumbullimit të ujërave të zeza.	Vranjina: Përfunduar sistemin i trajtimit të ujërave të zeza (parashikuar të jetë një ligatinë e ndërtuar)	Vranjina: sistemi i trajtimit të ujërave të zeza përdoret si një vend demonstrimi.	Rregullisht	Raportet e progresit të projektit	MTEP, Bashkia e Podgoricës, MEFPA, pronarët e restoranteve.
Zona bimore mbrojtëse e ujit rehabilitohet në zonat pilot për të reduktuar sedimentimin dhe gërryerjen. (S)	Janë identifikuar 2 zona të degraduara për vendet e rehabilitimit; nuk ka të dhëna për mbulesën bimore.	Janë identifikuar treguesit, niveli bazë dhe synimet për mbulesën bimore; Janë përgatitur TOR për kontratat	Janë dhënë kontratat dhe ka filluar puna rehabilituese.	Ka përfunduar 50% e punës rehabilituese.	Është përfunduar 100% e punës rehabilituese.	Rregullisht	Raportet e progresit të projektit	MEFWA